



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:179343

Datë: 08.11.2024

Numri i dokumentit: 06422727

2023:191997

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa , duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit, Nd.nr.53/24 të datës 04.11.2024 e lidhur në zyrën e ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit I.S nga Kaçaniku dhe përfaqësuesit të të dëmtuarës,APK-Njësia në Kaçanik, F. L, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.1132/23 të dt. 06.09.2023, për shkak të veprës penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, më datën 08.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET marrëveshja e ndërmjetësimit Nd.nr.53/24 e datës 04.11.2024, e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit I.S nga Kaçaniku dhe përfaqësuesit të të dëmtuarës, APK-Njësia në Kaçanik, F. L.

HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1132/23 e dt. 06.09.2023 dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurit I. (A...) S. nga Kaçaniku, i lindur me dt...., me nr.personal: ..., për shkak të veprës penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën, PP/II.nr.1132/23 të dt. 06.09.2023, të pandehurin I.S nga Kaçaniku e ka akuzuar për veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të datës 30.10.2024, palët në procedurë janë pajtuar që lënda penale e evidentuar si 2023:191997, të procedohet sipas procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata duke vepruar konform, nenit 8 par.3 të Ligjit për Ndërmjetësim vendosi që çështja të dërgohet në Zyrën e Ndërmjetësimit.

Me datën 04.11.2024, në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, është arritur marrëveshja ndërmjetësimit, Nd.nr.53/24, në mes palëve në procedurë, dhe atë në mes të pandehurit I.S nga Kaçaniku dhe përfaqësuesit të të dëmtuarës, APK-Njësia në Kaçanik, F. L.

Andaj, Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovoi këtë Marrëveshje, pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

2023:191997 datë 08.11.2024

Gjyqtarja
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë ne afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.